



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 03-02/3401/16
Dep. DPKI	B. Prot. 03-02/3401/16
Nr. l faq. 02	Data 29.09.2016
Broj stranica 02	Datum 29.09.2016
Nr. pages 02	PRISHITË

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.09.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2063/16, për z. Hidajet Ahmeti, Drejtor i Administrates në Komunën e Klllokotit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Hidajet Ahmeti, Drejtor i Administrates në Komunën e Klllokotit, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Ahmeti është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Ahmeti është njoftuar me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka bërë shkresë paralajmërues” zyrtarit të lartë, me të cilën i është dhënë një afatë ligjor shtesë, brenda të cilës duhet të largohet nga funksioni menaxherial apo të mbyllë biznesin privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Zyrtari i lartë, z. Ahmeti ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3266/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat N.N.P “Termo Plast”. Me këtë rast z. Ahmeti e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

